



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr. 423, datë 29.06.2016**

**“Për**  
**shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes LANDESLEASE SHA për revokim të**  
**Vendimit nr. 412, datë 21.04.2016 të Komisionit të Konkurrencës”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- |                       |         |
|-----------------------|---------|
| ▪ Lindita MILO (LATI) | Kryetar |
| ▪ Servete GRUDA       | Anëtar  |
| ▪ Koço BROKA          | Anëtar  |
| ▪ Iva ZAJMI           | Anëtar  |
| ▪ Eduard YPI          | Anëtar  |

Në mbledhjen e datës 29.06.2016 shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes “Landeslease” SHA për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 412, datë 21.04.2016 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e qirasë financiare dhe në sektorin financiar”.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, gërma d, dhe neni 46.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të kërkesës së “Landeslease” SHA për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 412, datë 21.04.2016,

**VËREN SE:**

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 412, datë 21.04.2016 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e qirasë financiare dhe në sektorin financiar”, në bazë të nenin 24, germa d), nenin 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka vendosur:

- I. Shoqëria “Landeslease” SHA ka detyrimin për ndryshimin e nenit 7, pika 4, të kontratës së qirasë financiare nr. 1464, nr. 339 rep, nr. 208 kol, datë 31.01.2015, duke ja lenë “qiramarrësit”, të drejtën e përzgjedhjes së*

*ndërmarrjes siguruese, me qëllim sigurimin e automjetit objekt- kontrate me çmimin më të mirë të mundshëm.*

- II. Bankat e nivelit të dytë, ndërmjetësit financiarë dhe të gjitha shoqëritë e licencuara në sektorin financiar kanë detyrimin tu sigurojnë klientëve lirinë e zgjedhjes në çdo rast, duke hequr klauzolat e ekskluzivitetit apo ato përjashtuese.*

Ndërmarrja “LANDESLEASE” SHA me anë të shkresës së saj nr. 547 prot., datë 20.05.2016, kërkon nga Komisioni i Konkurrencës: Revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 412, datë 21.04.2016 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e qirasë financiare dhe në sektorin financiar”, duke paraqitur dhe argumentet e saj mbi të cilat e mbështet kërkesën e saj.

Gjithashtu, kundër këtij vendimi ndërmarrja “Landeslease” SHA ka paraqitur ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku kërkon shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 412, datë 21.04.2016 dhe marrjen e masës të pezullimit tërësisht të tij deri në përfundim të gjykimit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e shqyrtoi kërkesën për marrjen e masës së pezullimit dhe vendosi rrëzimin e saj, ndërsa lidhur me themelin e çështjes është ende në shqyrtim.

Në bazë të kërkesës së ndërmarrjes “Landeslease” SHA nr. 637 prot, datë 13.06.2016, Autoriteti i Konkurrencës realizoi një seancë dëgjimore me përfaqësues të kësaj ndërmarrjeje më datë 29.06.2016, ku ndërmarrja paraqiti argumentet e saj verbalisht.

Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes “Landeslease” SHA dhe argumenteve të dhëna në formë shkresore dhe verbale përpara Komisionit të Konkurrencës, për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 412, datë 21.04.2016 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e qirasë financiare dhe në sektorin financiar”, Komisioni i Konkurrencës arriti në përfundimin se: duke mos u ndodhur para rasteve të përcaktuara në nenin 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe nisur nga natyra e vendimit, nuk ka asnjë arsye për revokim të Vendimit nr. 412, datë 21.04.2016 të Komisionit të Konkurrencës.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma d, nenin 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “Landeslease” SHA për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 412, datë 21.04.2016 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e qirasë financiare dhe në sektorin financiar”.

2. Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 412, datë 21.04.2016 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e qirasë financiare dhe në sektorin financiar”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi shoqërisë “Landeslease” SHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

<b>Servete GRUDA</b>	<b>Koço BROKA</b>	<b>Iva ZAJMI</b>	<b>Eduard YPI</b>
( _____ )	( _____ )	( _____ )	( _____ )
<b>Zv/Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
			<b>Lindita MILO (LATI)</b>
			_____
			<b>K R Y E T A R</b>

### **MENDIMI I PAKICËS**

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. prot, datë 29/06/2016  
**“Për**

**Shqyrtimin e Kërkesës së Ndërmarrjes LANDESLEASE SHA Për Revokimin e Vendimit Nr 412, datë 21.04.2016 të Komisionit të Konkurrencës”** kam mbajtur qëndrimin kundër, me arsyetimin e mëposhtëm :

Në datën 23.05.2016, ka ardhur në Protokollin e Autoritetit të Konkurrencës, nga kompania Landeslease.sh.a, ankesa për Revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr.412, datë 21.04.2016, shqyrtuar në mbledhjen e Komisionit të Konkurrencës të datës, 29.06.2016, ku u ndërмор Vendimi Nr 423, datë 29.06.2016 “Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes Landeslease SHA për revokimin të vendimit nr 412, datë 21.04.2016 të Komisionit të Konkurrencës”

Si anëtar i Komisionit të Konkurrencës unë nuk kam marrë pjesë në mbledhjen e datës 21.04.2016, ku është marrë Vendimi i Komisionit nr 412, për arsye objektive.Lidhur me Vendimin Nr 412 të Komisionit jam dakort me pikat II dhe III, të pjesës vendosi të Vendimit ku midis të tjerash thuhet se “II-Bankat e nivelit të dytë,... kanë detyrimin financiar t’u sigurojnë klientëve lirinë e zgjedhjes së

shoqërisë së sigurimit për çdo kontratë, duke hequr klauzolat e ekskluzivitetit apo përjashtuese në formën shkresore, por edhe në zbatimin real të tyre”

Ndërsa lidhur me mosrishikimin e pjesës së Vendimit të Komisionit nr 412 që ka të bëjë me pikën I “Shoqëria “Landeslease” SH.A ka detyrimin për ndryshimin e nenit 7, pika 4, të kontratës së qirasë financiare nr 1464, nr 339 rep, nr 208 kol, datë 31.01.2015, duke ja lënë “qiramarrësit” të drejtën e përzgjedhjes së ndërmarrjes siguroese, me qëllim sigurimin e automjetit objekt-kontrate me çmimin më të mirë të mundshëm” kam shprehur qëndrimin KUNDER me arsyetimin bashkëlidhur.

-Në aspektin proçedural, në ligjin bazë të Funkcionimit të Autoritetit të Konkurrencës Nr 9121, datë 28.7.2003 Për Mbrojtjen e Konkurrencës ndryshuar, në Nenin 39 E drejta e palëve për t’u dëgjuar, thuhet shprehimisht:”Ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve kanë të drejtë të shprehen për çështjen, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga Komisioni. Komisioni e bazon vendimin vetëm në pretendime, për të cilat palëve u është dhënë mundësia për t’u shprehur.” Kjo kërkesë e ligjit nuk është mbajtur parasysh gjatë procesit të Vendimarrjes , në datën 21.04.2016

-Gjatë seancës dëgjimore të datës 29.06.2016, nga pala ankimuese u sollën argumeta për çështjen në themel, që për mua ishin bindëse në funksion të revokimit të vendimit. Lidhur me këtë u shpreha në mbledhjen e Komisionit para marrjes së Vendimit. Duke qënë në situatën se si në aspektin proçedural ashtu dhe për aspektin e trajtimit të çështjes në themel plotësoheshin kërkesat e Nenit 46 Revokimi i Vendimeve të Ligjit Nr 9121, datë 28.7.2003 ”Për Mbrojtjen e Konkurrencës” ndryshuar, vota ime ishte për Revokimin e Vendimit. Për rrjedhojë vota ime është kundër Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr 23, datë 29.06.2016.

Komisioner  
Koço Broka